



Njihni të drejtat tuaja!

Informacione për femrat refugjate

Albanisch

Programi i Mbështetjes „Integrimi përmes kualifikimit (IQ)“

Autorësia

Botuesi:

IQ Netzwerk Niedersachsen (Rrjeti IQ Niedersachsen)

Nënprojekti „Fokus Flucht“ (Fokusim arratisja)

Flüchtlingsrat Niedersachsen e.V.

(Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V.)

Röpkestraße 12

30173 Hannover

www.nds-fluerat.de

www.netzwerk-iq.de

www.migrationsportal.de



Redaksioni:

Vivien Hellwig, Flüchtlingsrat Niedersachsen e.V. (Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V.)

Faqosja:

Vivien Hellwig, Flüchtlingsrat Niedersachsen e.V. (Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V.)

Marion Simmering, RKW Nord GmbH, IQ Netzwerk Niedersachsen (Rrjeti IQ Niedersachsen)

Ilustrimet:

© Hanna Katrin Krümpfer

Gjendja: Maj 2017

Programi i Mbështetjes „Integrimi përmes kualifikimit“ synon të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme integrimin e të rriturve me një sfond migrues në tregun e punës. Programi financohet nga mjetet e Ministrisë Federale të Punës dhe Çështjeve Sociale (BMAS). Partnerët në zbatim të programit janë Ministria Federale e Arsimit dhe Kërkimeve (BMBF) dhe Agjencia Federale e Punësimit (BA).

Das Förderprogramm „Integration durch Qualifizierung (IQ)“ wird durch das Bundesministerium für Arbeit und Soziales gefördert.



Bundesministerium
für Arbeit und Soziales

In Kooperation mit:



Bundesministerium
für Bildung
und Forschung



Bundesagentur
für Arbeit

Informacione për gratë e arratisura

Imazhi i refugjatit në debatin aktual është i karakterizuar kryesisht nga meshkujt. Por në të vërtetë pothuajse një e treta e refugjatëve në Gjermani janë gra. Gratë në arrati janë të prekura me përmasa të gjëra të eksperiencave të dhunës, sulmeve seksuale, traumave të ndryshme dhe të ndarjeve familjare. Shumë gra ikin nga një vend për shkak të persekutimit gjinor të tyre. Për fat të keq, diskriminimi i shumëfishtë dhe eksperiencat nga dhuna e përjetuar nuk kanë të ndalur në asnjë kufi shtetesh. Gjithashtu edhe në Gjermani, gratë janë të ekspozuara ndaj dhunës dhe diskriminimit të tyre. Është mëse e rëndësishme të njihni të drejtat tuaja si një grua dhe të dini se ku të merrni mbështetje të duhur në rast nevojë.

Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V. është i përkushtuar për një shoqëri me të drejta të barabarta dhe për mbrojtjen e të gjithë refugjatëve.

Me nënprojektin e IQ „Fokusimi në arratisje“, Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V. dëshiron të mbështesë veçanërisht gratë refugjate në jetën e tyre në Gjermani. Kualifikimi dhe njohuria janë një pjesë përbërëse e rëndësishme, për të udhëhequr një jetë të vetëpërcaktuar dhe të pavarur nga te tjerët.

Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V. është një partner i projektit në Rrjetin IQ Niedersachsen. Kjo broshurë është zhvilluar në kuadër të partneritetit që ekziston, kështu që oferta e mëposhtme, si dhe disa linqe dhe informacione ju referohen Landit (federatës) së shtetit të Niedersachsen-it (Saksonisë së Ulët).

Ne ofrojmë me sa vijon:

- Workshops (Punëtori) për gratë refugjate në botën e punës në Gjermani
- Workshops (Punëtori) të hapura për gratë me një prapavijë ikjeje (p.sh. të drejtat si grua, procedurat e azilit, të drejtat e fëmijëve etj.)
- Workshops zur beruflichen Anerkennung von im Ausland erworbenen Qualifikationen
- Mbështetje për vetëorganizimin e grave refugjate

Kontakti:

Vivien Hellwig, Flüchtlingsrat Niedersachsen e.V.
(Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V.)
Röpkestraße 12
30173 Hannover

Telefoni: +49 (0)511/98 24 60 30

Telefoni direkt: +49 (0)511/85 03 34 90

E-Mail: vh@nds-fluerat.org

A keni nevojë për ndihmë?

Kontakttoni një qendër lokale të këshillave. Qendra këshillimi në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim:

www.nds-fluerat.org/beratungsstellen

Informacione të përgjithshme për gratë refugjate nga Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e. V.: **www.refugee-women.de**

Telefoni i ndihmës për gratë:

0800/0 116 016 (falas, anonime, në shumë gjuhë)

Telefoni i krizës së Niedersachsen-it KUNDËR martesës së detyruar:

0800/0 667 888 (falas, anonim)

Telefoni i ndihmës „Gratë shtatëzënë në nevojë“ i Qeverisë Federale:

0800/40 40 020 (falas, anonime, në shumë gjuhë)

Procedura e azilit

Intervista është pjesa më e rëndësishme e procedurës së azilit. Shpeshëherë është e vështirë të flitet për arsyet e ikjes. Por edhe në qoftë se një e tillë dhemb apo është e pakëndshme - është e rëndësishme që të paraqisni plotësisht të gjitha arsyet tuaja. Ju mund të kërkonti që të dhënat e juaja të mos kalojnë tek ndonjë person i tretë - as tek personat nga familja juaj!

Është e dobishme të vizitoni një qendër këshillimi para intervistës ose seancës dëgjimore në Zyrën Federale për Migrim dhe Refugjatë (BAMF). Në atë konsultim ju mund të përgatiteni për intervistën. Për dëgjimin tuaj në BAMF ju mund të shoqëroheni nga një person përcjelljeje ne cilësi të „përkrahësit“.

Ju keni të drejtë të aplikoni për azil për veten tuaj, me arsyet tuaja - edhe nëse keni ikur së bashku me familjen. Në rast të një kërkesë të përbashkët për azil, do të dëgjoheni vetëm.

Ju mund të shprehni dëshirën që për seancën dëgjimore të keni një grua si një dëgjuese dhe një grua si interprete gjuhe (përkthyes).




Persekutimi i bazuar në gjininë tuaj mund të jetë një arsye për një vendim pozitiv për aplikimin tuaj. Gjithashtu dhuna dhe shtrëngimi në familje mund të jenë gjithashtu arsye për azil.

Ekziston e drejta për përkrahje të veçantë për gratë shtatëzëna, prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën 18 vjeçare, personat që kanë vuajtur tortura, përdhunime ose forma të tjera të rënda të dhunës psikike, fizike ose seksuale. Fëmijët e pashoqëruar nën moshën 18 vjeçare, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit gjithashtu mund të kërkojnë përkrahje të synuar për vete. (Direktivat e BE-së 2013/33/BE dhe 2001/95/ BE)

Kontakttoni një qendër lokale të këshillave. Qendra këshillimi në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim:

www.nds-fluerat.org/beratungsstellen

Cilat të drejta kanë fëmijët e mi?



Pas shpërndarjes në një komunë, fëmijët tuaj me mbushjen e moshës 1. vjeçare do të kenë të drejtën për një vend të kujdesit ndaj tyre. Nga moshja 3. vjeçare fëmijët tuaj kanë të drejtë për një vend në kopshtin e fëmijëve. Çdo fëmijë -si vajzat ashtu edhe djemtë- kanë të drejtën dhe obligim për të ndjekur shkollën pas moshës 6. vjeçare.

Ekziston ndihmë për përkujdes ndaj fëmijëve dhe aktivitete të kohës së lirë për fëmijët. Për nënat ose baballarët e vetëm me fëmijët, ka edhe më shumë ndihma.

Kontaktoni një qendër lokale të këshillave. Qendra këshillimi në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim:

www.nds-fluerat.org/beratungsstellen

Ose kontaktoni Rrjetin-Prind-të-Migrantëve në Niedersachsen (MEN)

www.men-nds.de

Çfarë mund të bëj nëse ekziston dhunë kundër meje apo fëmijëve të mi?

- Ndaj asnjë njeriu, pavarësisht nëse ndaj një grua, një burri apo një fëmije, nuk duhet të ushtrohet dhuna, askush nuk mund të detyrohet të kryejë marrëdhënien seksuale.
- Dhuna në qendrën e strehimit, në martesë, në familje ose nga miqtë është e ndaluar.
- Dhuna në vendin e punës dhe në publik është e ndaluar.
- Rrethprerja (syneti) i vajzave dhe grave në organet gjenitale të tyre ndëshkohet penalisht në Gjermani.
- Askush nuk lejohet ta detyrojë një grua, një burrë ose një fëmijë për prostituim.

Këtu ju mund merrni ndihmë:

Telefoni i ndihmës për gratë: **0800/0 116 016** (falas, anonim, në shumë gjuhë) Asgjë nuk tregohet më tutje, nuk keni nevojë të thoni emrin tuaj dhe asgjë nuk do të ndodhë pa „Okay-n“ (lejen) tuajin. Njerëzit në telefon mund të flasin shumë gjuhë të ndryshme. Ka edhe strehimore të grave, për të mbrojtur gratë.

A nuk është martesa juaj me vetëdëshirë (vullnetare)?

- Në Gjermani, nuk duhet të martohesh përshkak një detyrimi.
- Ju nuk keni nevojë të martoheni me dikë, nëse nuk dëshironi një gjë të tillë.
- A nuk mund të zgjedhësh kush, apo kur të martohesh?
- A doni të ikni nga martesa juaj, a nuk e dini se si?

Këtu ju merrni ndihmë:

Telefoni i krizës së Niedersachsen-it KUNDËR martesës së detyruar: **0800/0 667 888** (falas, anonim) gjermanisht dhe turqisht, në rast nevojë edhe persisht, arabisht dhe kirmanci.

Cfarë ndodh me lejen time të qëndrimit në rast të një ndarjeje?

Nëse juve vetvetiu ju është njohur e drejta për mbrojtje si refugjat, ju keni leje qëndrimi pavarësisht nga bashkëshorti juaj. Se a jeni të ndarë ose a jetoni së bashku, nuk është e rëndësishme për lejen e qëndrimit. Gjithashtu edhe të afërmit e refugjatëve të cilëve ju është njohur e drejta e refugjatit, shpeshëherë marrin gjithashtu të drejtën e tyre të qëndrimit nëpërmjet azilit të familjes.

A keni ardhur në Gjermani përmes bashkëshortit tuaj dhe doni të ndaheni?



Parimisht, partnerja e ardhur më pasë apo partneri i ardhur më pasë ka të drejtën e tijë të qëndrimit pas një ndarje, vetëm nëse një jetë e përbashkët martesore ka ekzistuar për të paktën tri vite të tëra.

Nëse vjenë deri tek një ndarje para mbushjes së atyre tri viteve, një leje qëndrimi e pavarur mund të lëshohet vetëm nëse ekzistojnë arsye të duhura serioze. Për shembull, sie arsye të tilla mund të jenë: Ju dhe fëmijët tuaj përjetoni dhunë në familje, ose si një grua e divorcuar (shkurrezuar), ju duhet llogaritni me persekutimin tuaj nëse ktheheni në vendin e origjinës suaj.

Kontakttoni një qendër lokale të këshillave. Qendra këshillimi në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim:
www.nds-fluerat.org/beratungsstellen

Marrëdhëniet e gjinisë së njëjtë dhe transeksualiteti

- Në Gjermani është e lejuar të keni një marrëdhënie me njerëz të së njëjtës gjini.
- Në procedurën e azilit i kushtohet vëmendje e veçantë persekutimit serioz përshkak të homoseksualitetit.
- A jeni të diskriminuar për shkak të seksualitetit tuaj?
- A keni nevojë për mbështetje të mëtejshme si homoseksual apo transeksual?

Këtu mund të gjeni mbështetjen e duhur:

www.queer-refugees.de

www.queer-refugees-niedersachsen.de

Shëndeti dhe sëmundjet

Në raste urgjente ju gjithmonë keni të drejtën e mjekut - madje edhe pa dokumente. Numri i thirrjes emergjente është: **112**.

Ju keni të drejtë për trajtim mjekësor në rast sëmundjeje fizike ose mendore. Punonjëset sociale dhe punonjësit social mund t'ju ndihmojnë të gjeni një mjeke apo një mjek të duhur për ju. Për shërbimet shtesë duhet parashtruar kërkesë përkatëse.

Pa dokumente të qëndrimit ju merrni ndihmë këtu:

www.medibueros.m-bient.com ose pranë **Malteser Migranten Medizin Hannover**, **www.malteser-hannover.de**, **0511/169 54 30**

Në rast traumatizimi, mund të ju ndihmojë më tutje Rrjeti për refugjatët e traumatizuar në Niedersachsen e.V. (NTFV):

www.ntfn.de, **0511/856 44 510**

Shtatëzënia

Si një grua shtatzënë ju nevojitet një mbrojtje e veçantë. Kërkoni mbështetje për strehim dhe furnizim të përshtatshëm për ju. Gjatë shtatzënisë dhe pas kësaj Ju keni të drejtë për kujdes të veçantë mjekësor. Para dhe pas lindjes, ju keni të drejtë të mirrni ndihmën e një mamie.

A jeni shtatzënë dhe a keni pyetje? A keni probleme ose keni frikë nga shtatëzënia?

Telefoni i ndihmës „Shtatëzënë në nevojë“ i Qeverisë Federale:

0800/40 40 020

(falas, anonim, në shumë gjuhë)



Së punuari në Gjermani

Është e rëndësishme të ndjekësh një kurs gjuhe. Të jesh në gjendje të flasësh gjermanishten është e dobishme si për punën, arsimin ose studimet. Kurset e gjuhës në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim: **www.fluechtlinge.niedersachsen.de**

Për të punuar gjatë procedurës së azilit dhe kur keni një leje tolerimi (tolerancë), ju nevojitet leja e Zyrës për të Huaj. Ju keni mundësin të punoni edhe pa lejen e burrit tuaj. Gratë, sikurse burrat, mund të kenë një xhirollogari banke (konto) në vete.



A keni mësuar një profesion pune jashtë vendit? Ju mund të lini të ju njifet në Gjermani kualifikimi juaj profesional i jashtëm. A keni studiuar në vendin tuaj të origjinës? Do të dëshironit të studioni këtu, ose nëse është dashur të ndërprisnit studimet tuaja? Ekzistojnë mundësi për të studiuar në Gjermani. Informacione të duhura gjeni këtu:

www.migrationsportal.de/studieren-in-niedersachsen oder **www.migrationsportal.de/arbeiten-in-niedersachsen**

Ju mund të punoni në Gjermani edhe pa pasur një kualifikim profesional. Ka qendra këshillimi për t'ju ndihmuar të gjeni punë ose trajnime profesionale. Nëse nuk keni një diplomë të shkollës, ju mund të ndjekni shkollën ose kurse përkatëse për të marrur një diplomë të shkollës.

Nëse punoni, ju keni të drejtë për pagën dhe mbrojtje në vendin e punës - edhe pa eksistuar një kontratë pune me shkrim. **www.faire-mobilitaet.de**

Kontaktoni një qendër lokale të këshillave. Qendra këshillimi në Niedersachsen mund të gjeni këtu në vijim: **www.nds-fluerat.org/beratungsstellen/** Qendrat e këshillave të njohjes dhe kualifikimit të Rrjetit IQ Niedersachsen janë: **www.migrationsportal.de/projekte-partner/anerkennungs-und-qualifizierungsberatung**

Ku mund të takohem me gra të tjera?

Në Gjermani ka vende të cilat janë vetëm për gratë. Ka gjithashtu edhe kurse ose oferta sporti ekstra për gratë. Këtu mund të takoheni dhe të shkëmbeheni me gra të tjera. Pyesni në vendin tuaj për kafenetë e grave ose vendtakimet e lagjes.



Ekzistojnë gjithashtu grupe të grave refugjatësh për refugjatët. Ata janë të angazhuar për një jetë më të mirë për gratë refugjate këtu dhe në vende të tjera, p.sh. „Woman in exile“ (gruaja në mërgim) apo „International women’s space“ (hapësira ndërkombëtare e grave). informacione gjeni në: **www.women-in-exile.net; www.iwspace.wordpress.com**

Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e.V.

Kush jemi ne

Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e. V. është një shoqatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 1984. Ne jemi një rrjet i pavarur i iniciativave të refugjatëve, organizatave bamirëse, famullive, sindikatave dhe individëve.

Ajo që ne kërkojmë

Këshilli i Refugjatëve Niedersachsen e. V. përkushtohet për atë, që të gjithë njerëzit të cilët qendren e jetesës së tyre e kanë në Gjermani, të arrijnë të marrin një të drejtë qëndrimi dhe njëherit të përfitojnë të drejtat e barabarta me të tjerët.

Ne jemi të angazhuar për një procedurë të drejtë azili dhe jemi të përkushtuar shumë të sigurojmë, që të gjithë refugjatët që nga fillimi e sipër të kenë mundësi për pjesëmarrje dhe mundësi edukimi dhe të kenë mundësin për të punuar. Ne mbështesim refugjatët pavarësisht nga statusi i tyre dhe punojmë me ta së bashku për të zbatuar të drejtat e tyre që kanë.

Flüchtlingsrat Niedersachsen e.V. ka punuar si një bartës nënprojekti i Rrjetit të IQ Niedersachsen-it që nga viti 2016 në programin e Mbështetjes „Integrimi përmes Kualifikimit (IQ)“





www.migrationsportal.de
www.nds-fluerat.org

Programi i Mbështetjes „Integrimi përmes Kualifikimit (IQ)“